



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 834 / Prot.
1

Tiranë, më 29 /08/2016

VENDIM

Nr. 53, datë 29 / 8 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 834 Prot., datë 01.08.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me emailin e datës 26.07.2016 ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës t'i vihet në dispozicion *kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Gjykatën e rrethit gjyqësor Kukës duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar.*

Koordinatori i të drejtës për informim, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me anë të emailit të datës 1.08.2016 i ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar me arsyetimin se: *Informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund të jepet. Në rast se ju keni ndonjë problematikë specifike, që kërkon kontaktet e brendshme të një punonjësi të Gjykatës, ju lutemi të na jepni më tepër informacion mbi arsyen e kontaktit, në mënyrë që të justifikohet dhënia e informacioneve. Mendojmë që dhënia e të dhënave të kontaktit të gjithë personelit të institucionit, të dhëna të cilat mund të përdoren për qëllime reklamimi ose vjedhje informacioni nuk është e përshtatshme (ju nuk keni sqaruar arsyen për të cilën kërkonti këto të dhëna).*

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislatorit, vlerëson se autoriteti publik ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 15, pika 1 e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Gjithashtu, vlerësohet se informacioni i kërkuar nga Z. është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Informacioni mbi organikën e stafit që punon në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, rolin, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare si dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës një përshkrim të strukturës organizative, funksionin, dhe detyrat e autoritetit publik.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. _____ ndaj Autoritetit Publik/Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____, Nr. 834 Prot., datë 01.08.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Gjykatën e rrethit gjyqësor Kukës duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar), brenda datës 05.09.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 29. 8 .2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI